



VENDIM

Data e vendimit: 6 qershor 2009

Lënda Nr. 63/08 (Case No. 63/08)

Danilo Cukic

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillimor për të drejtat e njeriut u mbledh me këtë përbërje:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Znj. Snezhana Botusharova

Z. John RYAN, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së lartcekur, të parashtuar sipas nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit këshillimor për të drejtat e njeriut,

Dhe pas ekzaminimeve të bëra, vendosë si vijon:

I. FAKTET

1. Ankuesi është banor i Kosovës, i cili tani jeton si person i zhvendosur në Matarushka Banja, Kraljevë, (Serbi). Para largimit nga konflikti në Kosovë në qershor të vitit 1999, ai ka banuar në fshatin Krligatë, komuna e Zubin Potokut.
2. Ankuesi është pronar i tokës, i dy shtëpive dhe i një ahuri me një sipërfaqe të përgjithshme prej 174 metra katror. Ankuesi kishte jetuar aty me familje për 20 vite.

3. Pas shpërthimit të armiqësive dhe zhvendosjes së ankuesit në Serbinë qendrore, shtëpia kishte mbetur e mbyllur dhe ishte e pajisur me të gjitha mobiljet. Fqinjët e ankuesit e kishin informuar atë në mars të vitit 2000 se shtëpia e tij ishte shkatërruar dhe shkatërruar.

4. Ankuesi ka paraqitur kërkesë kundër komunës së Zubin Potokut dhe IPVQ-ve me të cilën kishte kërkuar që dëmi i shkaktuar ndaj pronës së tij të kompensohet. Kërkesa ishte regjistruar tek Gjyqi komunal në Zubin Potok me 17 shtator 2004. Në ankesën e tij ankuesi ka kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj pronës së tij në shumë 77,000 €.

5. Ankuesi i referohet letrës së drejtorit të Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut dërguar me 26 gusht 2004 të gjithë kryetarëve të gjyqeve komunale dhe të qarkut dhe kryetarit të Gjyqit Suprem të Kosovës lidhur me kërkesat për kompensim për pronën e shkatërruar të ndodhura pas vendosjes në Kosovë të forcave të NATO-së në vitin 1999. Drejtori i Departamentit të drejtësisë në këtë letër kishte përmendur se ishin ngritur mbi 14,000 kërkesa të tilla. Ai iu referua “problemeve se paraqitja e tillë e madhe e ankesave do të hutoj gjyqet”, dhe kishte kërkuar që “rastet e tilla mos të caktohen për shqyrtim deri në kohën e vendimit të përbashkët se si të ndikohet në procedimin e këtyre rasteve”.

6. Deri tani ankuesi nuk është kontaktuar nga gjyqi komunal dhe gjyqi nuk është mbajtur asnjë seancë gjyqësore. Ankuesi ia ka paraqitur një kërkesë kryetarit të gjyqit komunal në Zubin Potok me 8 shtator 2008, me të cilën kishte kërkuar fillim urgjent të seancave gjyqësore. Ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare lidhur me kërkesën e bërë.

II. ANKESAT

7. Ankuesi pohon se Gjyqi komunal në Zubin Potok kishte ndaluar procedurën lidhur me kërkesën e tij për dëmtim të pronës së shkatërruar dhe se këto procedura nuk ishin kryer brenda kohës së arsyeshme (neni 6. 1 dhe neni 13 i Konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut (ECHR)). Ai më tej ankohet se me refuzimin e Gjyqit komunal në Zubin Potok për të vendosur për kërkesën e tij është shkelur e drejta e tij në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 i ECHR-së). Ai gjithashtu pohon se ka pasur shkelje të të drejtave të tija në jetë familjare dhe jetesës në shtëpi, meqë atij i ishte ndaluar të kthehej në shtëpinë e tij (neni 8 i ECHR-së).

III. SEANCAT PARA PANELIT

8. Ankesa është parashtruar me 15 dhjetor 2008 dhe është regjistruar të njëjtën ditë. Ankuesi përfaqësohet nga Jasmina Zupanjac nga Këshilli Danez për Refugjatë.

9. Paneli ia kishte komunikuar rastin PSSP-së me 28 prill 2009 dhe kishte kërkuar nga ai të komentoj në emër të UNMIK-ut për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rastit. PSSP kishte ofruar komentet me letrën e datës 18 maj 2009.

IV. LIGJI

10. Para shqyrtimit të rastit lidhur me bazueshmërinë e tij, Paneli duhet të vendos nëse duhet të pranojë rastin, duke marrë parasysh kushtet e pranimit, të cekura në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12.

11. Në komentet e tija PSSP-ë thekson se "rasti paraqitet të jetë *prima facie* i papranueshëm" bazuar në mos shterjen e mjeteve tjera ligjore. Ai thotë se që nga nëntori i vitit 2005 drejtori i Departamentit të drejtësisë ka ftuar gjyqet në Kosovë që të fillojnë me procedimin e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga personat e identifikuar fizik dhe për dëmet e shkaktuara pas muajit tetor të vitit 2000, meqë ai konsideron se në këto raste nuk ekzistojnë më pengesa për procesim efikas. Me 28 shtator 2008, pas konsultimeve me Këshillin gjyqësor të Kosovës, i cili u pajtua të sigurojë mbështetje logjistike për procesimin e kërkesave të mbetura, Departamenti i drejtësisë mendon se rastet e mbetura duhet të procedohen dhe gjyqet të informohen në përputhje me rrethanat e procesimit. PSSP thotë se rastet e cekura më lartë tani do të procedohen dhe gjyqet tek të cilat gjenden lëndët duhet të jenë në gjendje të lëshojnë vendime në kohë të duhur.

12. Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/12 parasheh se Paneli këshillimor mund të merret vetëm me çështjet për të cilat ai mendon se janë shterur të gjitha rrugët tjera ligjore për shkeljen e pohuar.

13. Paneli thekson se arsyetimi për kërkesën e shterjes është për t'i dhënë autoriteteve përkatëse, në veçanti gjyqeve, mundësinë që ta gjykojnë shkeljen e pohuar. Megjithatë, nga ankuesit vetëm kërkohet që të shterin mjetet ligjore që janë efikase dhe të disponueshme në teori dhe në praktikë (shih mes tjerash Gjyqin evropian për të drejtat e njeriut (ECtHR), *Vernillo v. Francë*, 20 shkurt 1991, publikimet e gjyqit, seritë A, nr. 198, faqe 12 dhe 27; ECtHR, 27 korrik 1999, *Selmouni v. Francë (GC)*, nr. 25803/99 dhe 76, ECHR, 1999-V).

14. Paneli konsideron se mospranimi bazuar në mos shterjen e mjeteve nuk mund të ekzaminohet në mënyrë të përgjithshme por duhet të ekzaminohet në kontest specifik të secilës prej ankesave të ndryshme. Kjo është në kontest se Paneli gjithashtu duhet të shqyrtoj nëse ankesat nuk prodhojnë ankesa tjera për shkak të pranueshmërisë së tyre (shih në kuptim të njëjtë Vendimin e Panelit të datës 22 maj 2009 në rastin nr. 38/08, *Milogoric*).

Shkeljet e pohuara të neneve 6. 1 dhe 13 i ECHR-së

15. Paneli konsideron se derisa ankuesi thirret në shkelje të nenit 6. 1 dhe 13 të ECHR-së ai në të vërtetë shtron dy ankesa (shih trajtimin e aprovuar në rastin *Milogoric* të përmendur më lartë; krahaso ECtHR, vendimin nr. 48776/99 mbi pranueshmërinë, 30 maj 2000, *Acimovic v. Kroaci*; ECtHR, Vendimin nr. 48778/99 mbi pranueshmërinë, 11 korrik 2000, *Kutic v. Kroaci*, nr. 48778/00). Në njëërën anë ai ankohet për faktet se për shkak të ndalimit të procedurave në gjyqin komunal ai

ka qenë në pamundësi të fitoj vendimin sipas kërkesës për dëmet e shkaktuara në pronën e tij. Paneli konsideron se kjo ankesë mund të ngre çështjen e së drejtës së tij të qasjes në gjyq të paraparë me nenin 6. 1 të ECHR, dhe të drejtën e tij në mjet ligjor efikas sipas nenit 13 të ECHR-së lidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Në anën tjetër, ai ankohet për zgjatjen e procedurave në gjyqin komunal për shkak të faktit se procedura është ngritur me 17 shtator 2004, dhe se kërkesa e tij nuk është shqyrtuar qysh nga atëherë. Kjo ankesë mund të ngre çështjen e së drejtës së tij ndaj një vendimi gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme në kuptim të nenit 6.1 të ECHR-së

16. Paneli thekson se në komentet e tija, PSSP-ja nuk ka cekur ndonjë mjet ligjor specifik në disponim të ankuesit për sa i përket pengesës apo kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore. Nga ana e tij, Paneli nuk sheh ndonjë mjet të tillë. Fakti se me 28 shtator 2008 gjyqet janë këshilluar të vazhdojnë me kërkesat e llojit të ankuesit nuk është relevante nga pikëpamja e mjeteve që duhet shterur nga ankuesi. Prandaj, paneli përfundon se ankesa nuk mund të refuzohet për mos shterjen e mjeteve ligjore në kuadër të kuptimit të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12.

17. Paneli konsideron se ankesat sipas nenit 6. 1 dhe 13 të ECHR ngrenë çështje serioze të fakteve dhe ligjit, vendimi i së cilave duhet të varet nga ekzaminimi i bazueshmërisë së rastit. Prandaj paneli përfundon se kjo ankesë nuk është e pabazë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12.

Shkeljet e pohuara të nenit 1 të Protokollit nr. 1

18. Ankuesi ankohet për shkeljen e të drejtave të tija në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1) për shkak të refuzimit të Gjyqit komunal në Zubin Potok për të vendosur për kërkesën e tij lidhur me dëmin e shkaktuar.

19. Në vendimin e tij të datës 22 maj 2009 mbi pranueshmërinë e ankesës në rastin Milogoric nr. 38/08, paneli ka zbuluar se debatet lidhur me kërkesën e ankuesit ishin ende të pazgjidhura tek gjyqi komunal dhe se kjo ankesë ishte e parakohshme dhe se është dashur të refuzohet për shkak të mos shterjes së mjeteve ligjore në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12.

20. Duke u bazuar në faktin se ankuesi ankohet se mjeti ligjor i ofruar nga gjyqi komunal deri më tash nuk ishte efikas, dhe se ai nuk është i obliguar të përdor mjetin ligjor, i cili nuk është adekuat apo efikas ose nuk rast të arsyeshëm për të pasur sukses, paneli dëshiron të shtoj se kjo pjesë e ankesës është gjithashtu e papranueshme sipas bazës tjetër

21. Në të vërtetë paneli thekson se kërkesa e ankuesit tek gjyqi komunal është në lidhje me shkatërrimin dhe plaçkitjen e pronës së tij. Sipas ankuesit, këto sulme kanë ndodhur mes muajit qershor të vitit 1999 dhe fundit të vitit 1999.

22. Paneli kujton se sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12, ai ka kompetenca vetëm ndaj "ankesave që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që nuk kanë ndodhur para datës 23 prill 2005, apo që kanë

lindur nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date në rastet ku ato fakte prodhojnë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Shkatërrimi dhe plaçkitja e pronës është akt i çastit që nuk prodhon shkelje të vazhdueshme (shih vendimin e panelit të datës 16 korrik 2008, Lajovic, nr. 09/08, pika 7).

23. Është e vërtetë se ankuesi para panelit nuk ankohet drejtpërdrejt për aktet e përmendura por vetëm për faktin se për shkak të ndalesës së shqyrtimit të ankesës ai ka qenë në pamundësi që deri tani të merr kompensim për dëmet e shkaktuara nga aktet e përmendura. Megjithatë, përderisa debatet e gjyqit i referohen rastit nga pikëpamja e së drejtës në pronë, ato nuk mund të veçohen nga aktet mbi të cilat bazohet ankesa tek gjyqi. Ose thënë në mënyrë pozitive, siç e ka bërë Gjyqi komunal për të drejtat e njeriut për sa i përket kompetencave të tija sipas ECHR-së):

"...Kompetenca e përkohshme e gjyqit është që të vendos në lidhje me faktet themelore të ndërhyrjes së pohuar. Dështimi pasues i mjeteve ligjore, që ka pasur për qëllim rregullimin e kësaj ndërhyrjeje, nuk mund ta sjell atë në kuadër të kompetencës së përkohshme të gjyqit" (EctHR (Dhoma e madhe), 8 mars 2006, Belcic v. Kroacia, nr. 59532/00, pika 77, ECHR, 2006-III).

24. Nga kjo del se kjo pjesë e ankesës bie, për çdo rast, jashtë kompetencës së panelit *ratione temporis* (shih në rastin e njëjtë me këtë, ECtHR, vendimi mbi pranueshmërinë i datës 7 nëntor 2002, nr. 61237/00), Acimovic v. Kroaci).

Shkeljet e pohuara të nenit 8 të ECHR-së

25. Ankuesi ankohet për shkeljen e të drejtave të tija në jetën familjare dhe shtëpi (neni 8 i ECHR-së) për shkak të faktit se qysh nga koha e largimit nga konflikti në Kosovë në vitin 1999 ai ka qenë i penguar të kthehet në shtëpinë e tij.

26. Paneli thekson se pasuria e tij përfshirë edhe shtëpinë e tij në Kosovë, në të cilën ka jetuar me familjen e tij, ishte shkatërruar diku mes muajit qershor 1999 dhe muajit mars të vitit 2000.

27. Sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK 2006/12, Paneli ka kompetenca vetëm për shqyrtim të "ankesave lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që nuk janë paraqitur më herët se 23 prill 2005 apo që kanë lindur nga faktet që janë paraqitur para kësaj date, aty ku këto fakte lindin nga shkelja e vazhdueshme e të drejtave të njeriut". Shkatërrimi i pronës është një akt i çastit, i cili nuk rezulton me shkelje të vazhdueshme.

28. Prandaj, kjo pjesë e ankesës është jashtë kompetencave të Panelit *ratione temporis*.

PËR KËTO ARSYE

Paneli unanimisht

- I DEKLARON TË PRANUESHME ANKESAT QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTËN PËR QASJE NË GJYQ DHE TË DREJTËN PËR MJET LIGJOR EFIKAS (NENI 6. 1 DHE 13 I ECHR-SË) DHE TË DREJTËN PËR NJË VENDIM GJYQSOR BRENDË NJË AFATI KOHOR TË ARSYESHËM (NENI 6.1 TË ECHR-SË);

- E DEKLARON TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.

John RYAN
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues i Panelit